

**VENDIM**  
**Nr.814, datë 3.12.2004**

**PËR NORMAT E STREHIMIT PËR FAMILJET QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMET SOCIALE TË STREHIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 17 e 18 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit, përfshijnë:
    - a) sipërfaqen minimale të banimit që i takon një personi;
    - b) numrin e personave për çdo dhomë të banuar.
  2. Sipërfaqja minimale e banimit, që i takon një personi të vetëm, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij vendimi, është 12.5 m<sup>2</sup>. Çdo personi tjetër shtesë mbi të parin, me moshë mbi 10 vjeç, i takon 7.5 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi, ndërsa çdo personi tjetër shtesë me moshë nga 5 vjeç deri në 10 vjeç i takon 3.75 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi.

Fëmijët nën moshën 5 vjeç nuk llogariten për efekt të përfitimit të sipërfaqes së banimit.

Kur blihen apartamente në treg, për t’u përdorur si banesa sociale me qira ose si banesa me kosto të ulët, sipërfaqja që i takon çdo personi shtesë mbi të parin mund të rritet deri në masën 15 për qind për strukturën e apartamentit që i takon familjes, sipas pikës 5 të këtij vendimi. Familjet që do të trajtohen me banesa me kosto të ulët, të blera në treg me norma më të larta se ato të përcaktuara në këtë pikë, të paguajnë, në mënyrë të menjëhershme, diferencën e kostos së sipërfaqes së tepërt, sipas udhëzimit të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.
  3. Individët me aftësi të kufizuar, të deklaruar nga komisionet përkatëse, që trajtohen sipas shkronjës “d” të nenit 5 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane”, të cilët kanë nevojë për përkujdesje, sipas ligjeve përkatëse, ku trajtohet statusi i tyre, përfitojnë 12.5m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi, e cila të jetë dhomë më vete.
  4. Përfitojnë dhomë më vete fëmijët me moshë mbi 10 vjeç, të sekseve të ndryshme.
  5. Numri i personave për dhomë të banuar dhe sipërfaqet korresponduese përcaktohen në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi.
  6. Normat e projektimit për sipërfaqet e banimit, të parashikuara në vendimin nr.567, datë 6.12.1993 të Këshillit të Ministrave “Për normat e projektimit të banesave”, nuk zbatohen për banesat që përdoren për programet sociale të strehimit.
  7. Vendimi nr.113, datë 20.1.1997 i Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit në banesat që ndërtohen me fondet publike”, shfuqizohet.
  8. Ngarkohen bashkitë dhe të gjitha institucionet, që sigurojnë banesa sociale me qira ose banesa me kosto të ulët, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

Tabela

Struktura e apartamentit	Garsoniere		1+1		2+1		3+1	
	Min.1	Max..2	Min.2	Max.3	Min.3	Max.4	Min.4	Max.6
Nr. i personave/apartament								
Sipërfaqja e banimit (m <sup>2</sup> )	12.5	20-21	20-21	27,5-29,75	27,5-29,5	35-38	35-38	50-56